



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura V-të  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 1/14  
Prishtinë, më 19.12.2014, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Bojan Mitić, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Visar Ymeri, Donika Kada- Bujupi, Jakup Krasniqi, Fikrim Damka,

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Avdullah Hoti-Ministër i Financave, Agim Krasniqi - Drejtor Departamentit të Buxhetit në MF, Asdren Osaj-MF, Besnik Tahiri - Klan Kosova, Sylejman Bllaku - Kosova Sot, Resmije Ballazhi-Kosova Pres, Dukagjin Maliqi- Rrokum, Rrezarta Zeka - RTK, Ramadan Islami – GIZ, Rejhane Zylfijaj - GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit

**R e n d i i d i t ë s**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015;**
- 3. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** - përshëndeti anëtarët e komisionit dhe të pranishmit dhe foli për rëndësinë dhe përvojën e tij dhe disa kolegëve që kanë pasur në këtë komision. Më tuje, njoftoi se komisioni ka pranuar një shkresë nga Kryetari i Kuvendit, që e ngarkon komisionin për buxhet e financa për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, sipas nenit 56 pika 2 e Rregullores së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit, ka vendos thirr seancën plenare për të hënë datë 22.12.2014, me pikën: Shqyrtimi në parim i Projektbuxhetit 2015. Kështu që, ne paraprakisht duhet të shqyrtojmë në pari projektligjin dhe të nxjerrim një rekomandim për Kuvend. Por, me që jeni në një situatë të urgjencës, për të mundësuar shqyrtimin në parim Projektligjit, në takimin e sotëm, do të duhej që votojmë për shmangien e Rregullores së Kuvendit dhe për këtë nevojitet një votim formal, prej 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm.

Kryetari - konstatoi se Komisioni, në pajtim me nenin 84 të kësaj Rregullore së Kuvendit, njëzëri vendosi për shmangien e Rregullore së Kuvendit, dhe për procedim me rendin e ditës, siç është propozuar.

## **2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015**

**Avdullah Hoti** – informojë se buxheti i cili është proceduar në Kuvend është i njëjti buxhet i cili është proceduar para datës 31 tetor 2014. Sa i përket përmbajtjes së buxhetit, në vitin 2015 janë paraparë të hyra prej 1 miliard e 576 milion euro, dhe pjesa me e madhe e këtyre të hyrave vjen prej doganave apo të hyrave kufi dhe në kuadër të kësaj, pjesa më e madhe vjen prej TVSH-së. Tek shpenzimet, janë 1 miliard e 682 milion euro, ku për paga ka një rritje prej 67.7 milion, që reflekton për gjithë vitin 2015, rritjen e plotë të pagave prej 25%, që ka ndodh në pjesën e parë të këtij viti. Për sigurimet shëndetësore ku janë ndarë 10 milion euro, transferet sociale janë të rritur 136 milion euro, duke reflektuar prapë rritjen e 25% të pensioneve dhe rritjeve tjera sociale që vinë nga buxheti i shtetit. Duke u siguruar, ne qëndrojmë pranë rregullës fiskale që është 2% e GDP-së.

**Visar Ymeri** - mendoj dhe u tha këtu se kemi një nguti të jashtëzakonshme për shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit, dhe si rezultat nuk po bëhet një trajtim i mirëfilltë i këtij ligji kaq të rëndësishëm për vendin dhe asnjë mundësi që Kuvendi, sadopak të bëjë përmirësimin e punës së qeverisë karshi kësaj çështje. Siç u tha edhe nga ministri, kemi një buxhet i cili është i njëjtë me atë që e ka dorëzuar qeveria e vjetër, dhe në vitin 2015 e dimë se nuk do të ketë ndryshime, kushedi çfarë në ndarjen e parasë publike dhe nuk do të presim ndikim në ekonominë e vendit, në një situatë ku jemi duke jetuar në momentet më të vështira sociale e ekonomike.

Sa i përket tabelës fillestare kryesore, të rritja e pagave, krahasuar me vitin 2014, nuk del se është 25%, por është 11%, ndërkohë që transferet sociale kemi të bëjmë me shumën të mëdha, dhe a ka të bëjë kjo në pensionet e veteranëve të luftës? Një shifër që nuk e kam kuptuar dhe mbase është shprehur gabimisht, ka të bëjë me parashikimet për rritjen e Bruto Produkti Vendor dhe po ta krahasojmë me përqindje del 5.07% , por ne e dimë se rritja ekonomike nuk ka me qenë në atë nivel për vitin 2015. Një çështje tjetër që e kemi ngritë edhe herave tjera kur është diskutuar buxheti dhe ka të bëjë me nenin 9, pika 3 me fondin e mirëbesimit të veriut, nuk është treguar në fakt se sa është ky fond, se sa para mblidhen e në çfarë projekte po shkojnë këto para dhe nuk ka kurrfarë transparence karshi Kuvendit. Po kërkohet nga deputetët që ta miratojmë buxhetin ashtu siç është ndarë për këtë fond, edhe pse një gjë të tillë është kundërshtim me ligjet e vendit. Pra, asnjëherë të paktën nuk është raportuar, që ta dimë se për çfarë para apo projekte po flasim!

**Donika Kadaj-Bujupi** – ashtu siç u tha, kemi një projektbuxhet identik me atë që ka përgatitur qeveria e kaluara dhe përderisa ky projektligj i buxhetit është përgatitur nga ish kryeministri Hashim Thaqi dhe nuk ka ndryshime, kjo lenë të kuptohet se kjo qeveri nuk ka asnjë plan për realizimin e një programi të vetë. Ministri na tha se ka qenë kohë e shkurtër, por unë mendoj se janë më shumë se dy javë dhe brenda kësaj kohe, një qeveri apo një ekip e mirëfilltë, i cili ka paraprakisht një plan për qeverisje, dhe mendoj se nëse dikush dëshiron të bëhet kryeministër duhet me e pas një plan qeverisës dhe me zbatue një program të caktuar, dhe kjo tani me këtë projektbuxhet të propozuar, nuk po ndodhë.

Shqetësimi tjetër është se nuk ka asnjë parashikim të rritjes së të hyrave, e që në praktikë do të thotë se nuk ka asnjë plan për luftë ndaj informalitetit dhe korrupsionit dhe kjo do thotë se do të ketë një përsëritje dhe përshtatje e vitit 2014, në mënyrën e njëjtë se si ka funksionuar ky vit. Nuk po e shoh se ka ndonjë përkrahje shtesë të kategoritë sociale. Çështja e rritjes së pagave për 25%, tashmë është bërë e ditur edhe në opinion, se me këtë projektbuxhet, nuk do të ndodh rritja e pagave, ashtu siç është premtuar. Janë paraparë 70 milion euro për investime kapitale, do të thotë se nuk do të kemi projekte zhvillimore, por përkundrazi do të ketë degradim në këtë aspekt. Një çështje tjetër, ka të bëjë me shpenzimet e dy ministrive shtesë që do të themelohen, dhe që do të kushton buxhetit rreth 300,000 euro,

pyetja ime është se si do të ndahet buxheti për këto dy ministri, a do të thotë kjo se do të mbetet pa ndërtuar ndonjë shkollë apo do të mbetet keq ndonjë spital?

**Besa Gaxherri** – ne kemi hyrë në procesin e punës me një buxhet i cili është i planifikuar nga një qeveri tjetër dhe natyrisht se nuk është lehtë me procesue, por megjithatë afatet ligjore i dimë dhe neve na duhet me proceduar më shpejtë. Unë uroj dhe shpresoj që do të punojmë bashkë, që struktura e të hyrave të buxheti të Kosovës të ndryshoj së paku për një mandat. Sa i përket të hyrave nga dividendat që është 30 milion euro, kisha pas dëshirë me na tregue se prej nga është planifikuar të realizohet kjo shumë? Te Kuvendi i Kosovës, shkruan se i ka 121 deputetë, ndoshta është bërë një gabim, pasi që ne e dimë janë 120 deputetë. Sa i përket shpërndarjes së investimeve kapitale në komuna, është shumë e padrejtë mënyra se si janë shpërndarë projektet, dhe në këtë aspekt ka nevojë për shumë ndryshime në të ardhmen.

**Safete Hadergjona**j - sa i përket projektligjit të buxhetit shohim se janë disa ndryshime të cilat janë bërë në pjesën tekstuale, krahasuar me ligjin e vitit 2014, dhe besoj që janë ndryshime të mira dhe pozitive. Por ajo çka shohim në brendi të tabelave buxhetore, janë çështje të cilat janë projektuar dhe janë në interes për qytetarin e republikës së Kosovës. Në bazë të të dhënave të treguesve makroekonomik, shohim se Kosovën po e përcjell një stabilitet financiar dhe një stabilitet makroekonomik dhe buxheti ka qëndrueshmëri dhe kjo është pozitive për periudhën që ka shkuar, por edhe për këtë qeveri që ka ardhur. Në bazë të projeksioneve në kornizën makrofiskale, shihet që rritja ekonomike për vitin 2015, do të jetë 4.1%, dhe unë dua t'iu besoj shifrave të tilla sepse ne kemi një trend të rritjes pozitive ekonomike gjatë viteve të mëparshme. Rritja e të hyrave të përgjithshme është 8.1%, më lartë krahasuar me vitin 2014. Të hyrat nga kufiri janë rritur në 3%, dhe ajo që duhet të vlerësohet është rritja e të hyrat buxhetore në vazhdimësi. Te hyrat vendore janë 17%, dhe nëse e shohim trendin e këtyre të hyrave, nga viti në vit ato janë rritur, gjë që është diçka pozitive sa i përket buxhetit, me qenë se të hyrat vendore janë të hyrat bazë për një rritje më të shpejtuar të të hyrave në përgjithësi.

Buxheti është projektuar duke respektuar rregullën fiskale të kufizimit të deficitit buxhetor prej 2% të BPV, që është në pajtim me Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë.

Sa i përket shpenzimeve, po shohim se këtu ka rritje dhe kjo ka ardhur si rrjedhojë e përfshirjes së rritjes së pagave prej 25% që ka ndodhur në muajin prill të këtij viti. Po ashtu kemi rritje të subvencioneve dhe transfereve, që përfshin rritjen e të pensioneve prej 25%, që ka ndodhur këtë vit, përfshirë edhe rritjen e pensioneve të punëtorëve të Trepçës që është 50%. Rritja e shpenzimeve ka ardhur edhe si rrjedhojë implementimit të reformave në shëndetësi dhe për zbatimin e legjislacionit të miratuar në këtë fushë, si dhe për reformat të cilat janë bërë në fushën e rendit dhe të sigurisë. Ajo çka ka qenë shqetësim për vite të tëra, tashmë në kuadër të projektbuxhetit janë planifikuar mjetet për implementimin e ligjit për veteranët e luftës dhe ligjit për ish të burgosurit politik. Prandaj, janë këto gjëra të cilat ne nuk mundemi me i tejkaluar heshtazi dhe të themi se nuk ka gjëra pozitive në këtë projektbuxhet, sepse janë përfshi të gjitha çështjet të cilat ka qenë shqetësime me vite të tëra.

**Jakup Krasniqi** - një e vërtet e madhe është se ky debat për projektbuxhetin në komision dhe në seancën plenare është tepër i ngutshëm, dhe ne jemi të gjithë të papërgatitur, por besoj që dhe kabineti i ri ka qenë i papërgatitur, në mënyrën se si e ka sjellë këtë projektligj në Kuvend. Qytetarëve u është premtuar se në vitin 2015, rritja e pagave do të jetë prej 25%, dhe nuk e di se si do të menaxhohen ata njerëz që kanë pritur rritjen e pagave, si qeveria do t'iu përgjigjet kërkesave të sindikatave profesionale të punëtorëve, pasi që ky buxhet nuk ju ofron atë rritje të premtuar, dhe nëse ruhet si duhet ajo përqindje që është bërë në vitin 2014, unë mendoj se do të ishte një sukses.

Një çështje tjetër që u tha se ka trende pozitive në shëndetësi e në arsim, unë mendoj se ndoshta edhe ministri është dashtë të na jep një pasqyrë më të qartë, si janë ndarë mjetet për këto dy ministri, pasi që këtu nuk u tha as një fjalë se si i ky projektbuxhet i përmbushë kërkesat për arsim dhe për shëndetësi. Ne të gjithë e dijë se kemi një ekonomi informale të madhe dhe një evazion të madh fiskal, por me një

menaxhim të mirë të buxhetit dhe luftim të ekonomisë informale dhe evazionit fiskal, buxheti i Kosovës mund të rritet edhe më shumë se 200 milion euro në vit. Por, nga ajo që na është prezantuar, jemi të bindur se cilësia që ofron ky projektbuxhet është larg nevojave dhe kërkesave të institucioneve dhe shoqërisë kosovare në përgjithësi.

**Avdullah Hoti** - në pyetjet e anëtarëve të komisionit, sqaroi: lidhur me pagat në vitin 2015, do të vazhdoj rritja e pagave që ka ndodhur në pjesën e parë të vitit. Tek transferet sociale është shuma e madhe dhe aty hyjnë edhe buxheti shtesë për bujqësinë që është subvencion në shumë prej 53 milion euro, janë paraparë 24 milion për veteranët e luftës për dhe për ish të burgosurit politikë 11 milion euro, si dhe shumat për kategoritë tjera sociale. Tek BPV, në tabelën 1 rritja e nominale është 5.3%, ndërsa rritja reale e GDP është parashikuar 4.1 %, sipas kalkulimeve që i ka bërë njësi makroekonomike. Nëse e shihni listën e shpenzimeve kapitale janë mbi 95% të projekteve të kontraktuara të cilat janë nënshkruar nga qeveria e kaluar dhe jemi të detyruar të respektojmë ligjin. Çështja e kabineteve, janë dy ministri pa portofol dhe e kemi një rezervë buxhetore që mundemi të akomodojmë nevojën për buxhet shtesë për këto dy ministri dhe nuk do të zvogëlohet buxheti për asnjë projekt kapital ose për shpenzimet tjera. Tek dividendat, janë paratë që do të merren nga PTK-ja, dhe sot Qeveria ka marrë një vendim që PTK të paguaj një dividend shtesë për qeverinë e Kosovës, dhe kjo është bërë në konsultim edhe me bordin e PTK-së, por pa e dëmtuar fare këtë kompani.

**Donika Kadaj-Bujupi** - pasi që këto dy ministri që janë në themelim e sipër janë krejtësisht të panevojshme, po ju thërras si ministër i përgjegjës për ruajtjen e buxhetit të shtetit, duke ditur nivelin e varfërisë në Kosovë, të mos lejoni që dikasterët përkatës të kenë më shumë se një zv. ministër dhe pjesa tjetër e parave të investohet në shëndetësi, arsim apo në nevojat tjera të qytetarëve. Po ju thërras këtu në komision që të reflektoni në kërkesën tonë, që mos ketë më shumë se një zv.ministër për dikaster, sepse po rëndoni shumë këtë buxhet që kemi.

Pas diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Rekomandim**

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

### **3. Të ndryshme**

**Kryetari**-njoftojë anëtarët se pas miratimit të Projektligjit në parim në Kuvend, komisioni do të takime të shpeshta, në mënyrë që të përfundojë shqyrtimin dhe amendamentimin e projektligjit.

**Mbledhja përfundoi në orën 11:45**

#### **Përqatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetar i Komisionit**

---

**Naser Osmani**